



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

Nr. 3349 prot.,

Vlorë, më 20.03.2023

PROJEKT- VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2023

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE DHE INDIVIDËVE, QË PËRFITOJNË SUBVENCIONIN E QIRASË NË TREG TË LIRË DHE VLERAT E SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR ÇDO RAST.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, neni 2 pika 34/a,b,c, pika 35, pika 36, pika 42, neni 33, neni 38, të VKM Nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Vendimin Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë;

**V E N D O S I**

- I. Të miratojë listën e familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast, sipas tabelës bashkëlidhur.
- II. Efektet financiare sipas pikës 1 do të mbulohen nga buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2023 .
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, si edhe Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Vlorë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni/55, pika 6.

Juriste: *S.Haxhiraj*  
Drejtor: *Z.Selmani*



KRYETARI  
*Dritan Leli*

LISTA E FAMILJEVE / INDIVIDIVE QE PERFITOJNE SUBVENCONIN E QIRASE PER VITIN 2023

(Grupi i parë)

Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	Kategoria sipas nënit 16 të ligjit nr.22/2018	Pertërja familjare	Struktura e apart.	Sipërfaqja e apart. m2	Qiraja mes e apart. ne treg per strukturen qe t'kan	Te ardhurat familjare muje	Kategoria sipas pikës 45 të nënit 2 të ligjit 22/2018	Afesia perball. e familjes	Qiraja e perball.	Sub vencioni muje	Subvencioni vjetor janar-dhjetor 2023
1	Sadete	Zenel	Daia	Kf.sëmure kronik	4	1+1	86	15000	Nd.ek. 4000	Pa të ardh.	0%	0	15000	180000
2	Shprese	Alli	Sulaj	e mosh. e vetm. PAK	1	1+1	71	5000	Nd.ek.	Pa të ardh.	0%	0	5000	60000
3	Majron	Shkëlqim	Myrtaj	Kryefamiljari PAK	4	garsonierë	45	10000	Nd.ek+PAK	Pa të ardh.	0%	0	10000	120000
4	Gamille	Melo	Sadikaj	e mosh. e vet. Kom.egj.	1	garsonierë	60	10000	16472	Ashu	15%	2471	7529	90348
5	Tana	Zini	Pasho	Fam.njëpr. Kom.egj.	2	1+1	71	15000	20000	Ashu	15%	3000	12000	144000
6	Vibertina	Fetah	Myftaraj	Fam.njëpr. Kom.egj.1PAK	3	garsonierë	38,73	10000	Nd.ek+PAK	Pa të ardh.	0%	0	10000	120000
7	Besnik	Agron	Kasaj	Fam.Kom.egj.	4	garsonierë	37	10000	25000	Ashu	15%	3750	6250	75000
8	Eliseo	Sokol	Musta	Fam.Kom.egj.	4	2+1	110	15000	42000	Ashu	15%	6300	8700	104400
9	Adrian	Dhimitri	Velo	1PAK	4		75,50	15000	Nd.ek+Pun.r	Ashu	15%	3000	12000	144000
10	Sheref	Malo	Palaj	2 pensionistë	2	1+1	63,50	10000	8588	Ashu	15%	1288	8712	104544
11	Lumturi	Hekuran	Limo	Fam.njëpr. Kom.egj.	2	1+1	72	12000	17844	Ashu	15%	2677	9323	111876
12	Ismet	Barjam	Hajrulla	Kf.sëmure kronik	1	garsonierë	145	10000	Nd.ek.2178	Pa të ardh.	0%	0	10000	120000
13	Flora	Xhelo	Jaupaj	1 PAK	1	garsonierë		10000	Nd.ek.11915	Pa të ardh.	0%	0	10000	120000
14	Harula	Bestin	Lamaj	Fam.njëpr. Kf.PAK	2	1+1		15000	Nd.ek.9723	Pa të ardh.	0%	0	15000	180000
15	Vili	Zini	Hoxhaj	lir.ban.pronar	2	garsonierë		10000	47648	Au	15%	7147	2853	34236
16	Bedrie	Nexhip	Mezani	fam.njëprindërore	3	1+1	105	9000	Nd.ek.	Pa të ardh.	0	0	9000	108000
17	Zelha	Shqip	Dule	e moshuar e vetmuar	1	garsonierë	54,7	10000	20322	Ashu	15%	3048	6952	83424
18	Olimbia	Andrea	Velko	e moshuar e vetmuar	1	garsonierë	56,5	10000	24260	Ashu	15%	3639	6361	76332
19	Ineska	Selto	Roshi	PAK	1	garsonierë	56,8	10000	Nd.ek.PAK	Pa të ardh.	0%	0	10000	12000
20	Leonard	Festim	Shabani	2 PAK, fam.kom.egj.	3	1+1	110	15000	Nd.ek.PAK	Pa të ardh.	0%	0	15000	180000
21	Violeta	Mahiq	Runa	e moshuar e vetmuar	1	garsonierë		10000	13588	Ashu	15%	2038	7962	95544
22	Albana	Mustafa	Lamçe	fam.njëprindër. 3PAK	4		87	15000	Nd.ek.PAK	Pa të ardh.	0	0	15000	180000
23	Marsela	Vladimir	Caushaj	fam.njëprindërore	4	1+1	58,5	15000	34807	Ashu	15%	5221	9779	117348
24	Fiqirete	Melo	Çela	lir.ban.pronar	3	1+1	58,6	15000	11532	Ashu	15%	1730	13770	165240
25	Llambi	Kostandin	Stefa	i moshuar i vetmuar	1	garsonierë	47	10000	16147	Ashu	15%	2422	7578	90936
26	Taze	Izet	Mataj	të moshuar, PAK	2	garsonierë	141	10000	9709	Ashu	15%	1456	8544	102528
												SHUMA	252313	2919756



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA V Lorë  
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

RELACION

Për projekt-vendimin

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE DHE INDIVIDËVE, QË PËRFITOJNË  
SUBVENCIONIN E QIRASË NË TREG TË LIRË DHE VLERAT E SUBVENCIONIT  
TË QIRASË PËR ÇDO RAST.**

Pranë Bashkisë Vlorë kanë paraqitur kërkesat për të përfitur subvencionin e qirasë për vitin 2023 familje dhe individë të pastrehë, të cilët deklarojnë se banojnë me qira në treg të lirë. Proçedurat e aplikimit dhe të vlerësimit vijnë të zhvillohen në bazë të Urdhërit të Brendshëm Nr.313 datë 21.11.2016 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë “Për proçedurat që duhet të ndiqen dhe dokumentacionin e nevojshem për të përfitur nga programi i bonusit të strehimit”.

Në zbatim të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, kreu V neni 33, 34, 35, 38, 39, të VKM Nr.362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, subvencioni i qirasë për banesat bëhet nga njësitet e vetëqeverisjes vendore, kur nuk kanë fond të lirë banesash sociale me qira, si rregull kur:

- a) Nuk zotërojnë fonde për investime të reja, ose blerje banesash në treg,
- b) Ndërtimi ose blerja e banesave nga tregu është më i kushtueshëm se subvencioni i qirasë,
- c) Familja është në kushtet e emergjencës për strehim dhe nuk përfiton nga asnjë program tjetër.

Subvencioni i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë së tregut të lire.

Masa e subvencionit të qirasë është në varësi të të ardhurave të familjes. Për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfitur atë, masa e subvencionit të qirasë mund të jetë deri në 100% të vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Sipas nenit 2 pika 36, të ligjit nr.22/2018 datë 3.5.2018, "Qira mesatare" është mesatarja e ofertave të qirave, të marra gjatë një viti, në tregun e lirë.

Qira reale, është vlera aktuale e çmimit të qirasë së një banese të caktuar në tregun e lirë.

Përparësi në subvencionimin e qirasë sipas sistemit të pikëzimit kanë, por pa u kufizuar në to, kategoritë e mëposhtme :

- a) Individët me statusin e jetimit
- b) Personat me aftësi të kufizuar
- c) Të moshuarit
- d) Familjet me më shumë se 4 fëmijë
- e) Invalidët e punës
- f) Familjet e policëve të rënë në detyrë
- g) Emigrantët e rikthyer
- h) Punëtori emigrant
- i) Azilkërkuesit
- j) Familjet e komunitetit rom
- k) Familjet e komunitetit egjiptian
- l) Viktimat e dhunës në familje
- m) Viktimat e trafikimit
- n) Prindërit e vetëm që kanë në ngarkim fëmijë
- o) Individët që i përkasin komunitetit LGBTI,
- p) Të miturit 14-18 vjeç dhe të rinjtë 18-21 vjeç, në konflikt me ligjin
- q) Vajzat nëna, pas daljes nga programi i banesave të specializuara
- r) Familjet me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private, sipas Aktit normative nr.3 datë 1.3.2012

Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.75, datë 30.09.2022 janë miratuar vlerat mesatare të qirasë së tregut të lirë në qytetin e Vlorës sipas strukturave të apartamenteve dhe vlerat maksimale të subvencionit të qirasë për familjet që përfitojnë 100 % subvencion.

Sipas VKM Nr.362 datë 29.05.2019, shtojca A, formula e përgjithshme e llogaritjes së vlerës së subvencionit të qirasë është :  $S=Qm-Qp$ , pra subvencioni është diferenca e qirasë mesatare të tregut të lirë me qiranë e përballueshme të familjes. Qiraja e përballueshme varet nga aftësia përballuese e familjes dhe kjo nga të ardhurat mujore neto të çdo familje, % e të ardhurave të familjes ndaj të ardhurave mesatare të përcaktuara nga INSTAT për qarkun Vlorë (Ames, Aulta, Ashulta, A0).

Me këtë projekt-vendim po sjellim kërkesat e paraqitura nga 26 familje dhe individë që rezultojnë me dokumentacion të plotësuar dhe janë të verifikuar në fakt, deri në datën 16.03.2023, të cilët deklarojnë se banojnë në banesë me qira dhe referuar të ardhurave mujore janë;

- familje/individë përfitues të ndihmës ekonomike
- familje/individë pa të ardhura

- familje/individë me të ardhura shumë të ulëta, krahasuar me të ardhurat mesatare sipas INSTAT për qarkun Vlorë.

-Familje të komunitetit egjiptian, që sigurojnë të ardhura nga punësimi i rastit, kryesisht në grumbullim lëndësh plastike dhe metalike.

-individë të moshuar të vetmuar që jetojnë me pension pleqërie

-persona PAK që trajtohen me ndihmë ekonomike invaliditeti, etj.


Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë i mbledhur në datën 16.03.2023 mori në shqyrtim të gjitha kërkesat së bashku me dokumentacionin e paraqitur.

Bazuar në dokumentacionin përkatës të çdo aplikanti, në rezultatet e verifikimit në terren të banesave dhe të kushteve të banimit, bazuar në aktet ligjore në fuqi për përcaktimin e masës së subvencionit, komisioni arriti në konkluzionet të cilat i miratoi në grup. Komisioni i Strehimit miratoi;

1. Familjet/individët që përfitojnë subvencionin e qirasë së tregut të lirë dhe masën e subvencionit rast pas rasti.
2. Skualifikimin e familjeve, të cilat mbas verifikimit në terren nuk banonin në banesa sipas kontratës së qirasë të paraqitur.
3. Rezultojnë raste ku deklarohet nga familjarët se vlera e qirasë në kontratën e qirasë përfshin edhe konsumin e energjisë elektrike dhe të ujit. Duke qenë se subvencioni i qirasë merr në konsideratë vetëm vlerën e qirasë mujore dhe jo konsumin e produkteve të tilla si ujë i pijshëm dhe energji elektrike, në këto raste qiranë sipas kontratës vendosi ta zbresë me 5000 lekë.
4. Familjet që janë ende në proces të përgatitjes së dokumentacionit dhe të verifikimit në terren do të trajtohen në vijim, në varësi të plotësimit të dokumentacionit.

Drejtor

Z. Selmani



Specialiste

D.Mustafai





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 3349 prot.,



VENDIM

Nr. 1, datë 16.03.2023

Në zbatim të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, neni 2 pika 34/a,b,c, pika 35, pika 36, pika 42, neni 33, neni 38, të VKM Nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë, i mbledhur sot në datën 16.03.2023, pasi mori në shqyrtim kërkesat e qytetarëve bashkë me dokumentacionin përkatës, për të përfituar nga projekti i subvencionimit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2023;

KONSTATOI SE

Deri në datën e sotme 16.03.2023 kanë paraqitur kërkesat rreth 31 familje dhe individë të pastrehë, që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë mundësi ekonomike për të përballuar vetë gjithë vlerën e qirasë. Bashkë me pamundësinë ekonomike këto familje paraqesin një sërë problematikash familjare dhe sociale. Një pjesë e aplikantëve e kanë kërkesën të përsëritur dhe janë përfitues prej vitesh të bonusit të qirasë. Banesat dhe kushtet e banimit sipas kontratave të qirasë janë verifikuar në terren së bashku me rajonet ku ndodhen këto banesa. Po kështu janë verifikuar në terren banesat e aplikantëve të rinj dhe kushtet e banimit sipas kontratave të qirasë.

Sa më lart komisioni,

VENDOSI

1. Të shqyrtojë të gjitha kërkesat dhe dokumentacionin e familjeve/individëve, që janë regjistruar pranë Bashkisë Vlorë për të përfituar subvencionin e qirasë në treg të lirë për vitin 2023. Të gjitha rastet e verifikuara në terren nga sektori që mbulon strehimin në bashkëpunim me rajonet, në adresat e banimit sipas kontratës së qirasë.

2. Të përcaktojë masën e subvencionit të qirasë që përfiton çdo aplikant

3. Kërkesat e paplotësuara dhe të paverifikuara të shqyrtohen në mbledhjet e ardhshme të komisionit.

4. Të miratojë dhënien e subvencionit të qirasë dhe vlerat përkatëse për 26 familje dhe individë sipas tabelës së mëposhtme, që do të mbulohej nga buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2023.

5. Një rast që deklaron se në masën e qirasë sipas kontratës dy palët qiradhënëse dhe qiramarrëse kanë vendosur të përfshijnë edhe konsumin e ujit të pijshëm dhe të energjisë elektrike, të merret në konsideratë qiraja mujore në vlerën 5000 lekë më pak. Kjo pasi ligji në fuqi për strehimin social me subvencion nënkupton vetëm vlerën e qirasë së banesës.

Nr	Emër /Atësia/ Mbiemër	Të ardhurat mujore (lekë)	Qiraja mesatare në treg të lirë	Subvencioni lekë/muaj	Subvencioni vjetor lekë/muaj
1.	Sadete Zenel Daja	Nd.ek.+pun.rastit 15000	15000	15000	180 000
2.	Shprese Ali Sulaj	Nd.ek.PAK	5000	5000	60 000
3	Marjon Shkëlqim Myrtaj	Nd.ek.PAK	10000	10000	120 000
4	Qamile Melo Sadikaj	Pension, 16472	10000	7529	90 348
5	Tana Zini Pasho	20000	15000	12000	144 000
6	Vibertina Fetah Myftaraj	Nd.ek.PAK	10000	10000	120 000
7	Besnik Agron Kasaj	25000	10000	6250	75 000
8	Eliseo Sokol Musta	42000	15000	8700	104 400
9	Adrian Dhimitri Velo	Nd.ek +pun.rast.	15000	12000	144 000
10	Sheref Malo Palaj	Pension, 8588	10000	8712	104 544
11	Lumturi Hekuran Limo	17844	12000	9323	111 876
12	Ismet Barjam Hajrulla	Nd.ek.	10000	10000	120 000
13	Flora Xhelo Jaupaj	Nd.ek PAK	10000	10000	120 000
14	Harula Besim Lamaj	Nd.ek.PAK	15000	15000	180 000
15	Ylli Zini Hoxhaj	47648	10000	2853	34 236
16	Bedrie Nexhip Mezani	Nd.ek.	9000	9000	108 000
17	Zeliha Shaip Dule	20322	10000	6952	83 424
18	Olimbia Andrea Velko	24260	10000	6361	76 332
19	Ineska Selfo Roshi	Nd.ek PAK	10000	10000	12 000
20	Leonard Festim Shabani	Nd.ek.PAK	15000	15000	180 000
21	Violeta Maliq Runa	13588	10000	7962	95 544
22	Albana Mustafa Lamçe	Nd.ek.PAK	15000	15000	180 000
23	Marsela Vladimir Caushaj	34807	15000	9779	117 348
24	Fiqirete Meto Çela	11532	15000	13770	165 240
25	Llambi Kostandin Stefa	16147	10000	7578	90 936
26	Taze Izet Mataj	9709	10000	8544	102 528

5. Me përfundimet e mësipërme të përgatitet projekt vendimi që do të paraqitet për miratim në Këshillin e Bashkisë.

#### KOMISIONI

1. Aulona Veizi
2. Zambak Selmani
3. Sonela Haxhiraj
4. Ali Çakëri
5. Orest Ruçaj
6. Manuela Prifti
7. Aulon Spaho

8. Brisilda Çobaj
9. Kanan Shakaj
10. Margarita Koço
11. Selim Haskoçelaj
12. Birçe Aliraj
13. Drita Mustafai